



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL II/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së II (dytë) për vitin 2026 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 18.02.2026
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve”;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Eko-Regjionin”;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025;**
- 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Raportit të komisionit për mbikqyrjen e kontratave në zonen Industriale në Shirokë;**

Kryesuesi- Përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës dhe për një pikë shtesë ‘Raporti për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

Flamur Bytyçi-përshendetje të pranishmit,urime për kabinetin e ri qeveritar,ju dëshirojë suksese në punë,faktikisht nuk e kam për këtë pikën shtrës mirpo në tërësi si rend dite po mendojë që është i ngarkum,kjo pikë dhe një pikë tjetër të shtyhet për një seancë tjetër.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,vetëm një pyetje kam,qka mundemi me bë ne si kuvend,nëse e miratojmë këtë raport a kemi ndonjë përgjegjësi ndaj këtij raporti ne si Kuvend.

Kryetari-Përshendetje për të gjithë,Ky raport u bë në bashkëpunim me komisionin qeveritar,ata kan kërku që të gjitha Komunat me dërgu në Asamble,dhe ata përsëri kan me dal në teren me kontrollu punën dhe në fund nëse i lëshojn mjetet,kjo është dëmi që e kan vlerësu komisioni në krahasim me Komuna tjera me dëme shumë më të vogla ne duhet me dërgu në Asamble dhe ne nuk e kemi përgjegjësin por e kan komisioni qeveritar që vjen dhe e vlerëson edhe një herë edhe i kryjnë obligimet ata.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,realisht vetëm raport nuk mundesh me i thën këtij,mirpo nuk e di a është konfidenciale që të përcaktohen emri dhe mbiemri i atyre të cilët jan dëmtu,sepse ky raport është si përfaqësor vetëm tregon shumën e dëmëve mirpo ne duhet të dijmë si anëtarë të KPF-së më detaishtë konkretisht cilat dëme jan bë,cila pjesë është më e dëmtune nëse nuk është konfidenciale.

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,pajtohem me Dardanin,dhe desha me ju pyt a na vjen një raport më i detajuar?nëse po a bën sotë deri në fund të kësaj seance dikush me përgadit dhe me na sjellë sepse nuk po dijmë asgjë vetëm një shifër 117.000 janë bër do dëme këtu dhe është

shumë e thatë për me e votu .Nuk është hera e parë që ne përballemi me këto vërshimeve dhe unë kam qenë pjesë e një komisioni të Komunës në mandatin e parë,ne kemi dhënë raport shumë të detajuar për secilën familje qka,dmth e kemi shtu edhe nëse ka qenë pjes laminati sa metra ² të një laminati jo vetëm në këtë formë

Florinda Isufaj-Përshendetje për të gjithë,unë jam kryesuese e këtij komisioni,ky raport është vetëm një raport përmbledhës,përndryshe të gjitha dosjet i kemi komplet për secilën,kemi pasë një takim me komisionin qendrorë dhe jan jashtëzakonisht të kënaqur me punën qe e kemi bërë në detaje mundem me ja prezantu,me fotografi me familje.Këtu nuk i kemi qitë emrat sepse Komisioni qëndror kan me bërë edhe një vlerësim mbas neve,dhe ky ka qenë rekomandim i tyre me vazhdu kështu.Përndryshe mundem me ja u sjellë të gjitha Kopjet.

Dardan Berisha-në parim nuk dyshojë aspak në punën dhe aktivitetine komisionit,mirpo secili drejtorë secili anëtar i komisionit që ne votojmë vetëm qka shohim dhe qka na vjenë këtu prezentë,unë nuk jam idhtar i asaj që me pru këtu me dosje shumë mirpo disa gjëra në detaje ne duhet me i ditë dhe duhet me i pas parasysh cilat familje jan prekur dhe unë jam pro që kjo me shku në Asamble dhe me u diskutu më gjërësisht por ne si KPF edhe në legjistaturën e kaluar që nuk i kemi kalu pikat ti si Kryesues i ki përcjellë në Kuvend dmth neve si rol i këtij komisioni na jepet vetëm si rekomandues dhe ne po rekomandojmë që gjërat me qenë më konkrete edhe me dashtë me shku në seancë të rregullt pikat e rendit ditës duhet me ardhë më të kompletuara që me ditë qka po votojmë ne si anëtar të komisionit.Dhe ju rekomandoj të gjithë Drejtorave që kur të vijjnë me qen më të kompletun dhe me qenë me konkret.

Laureta Tafaj-Ju kisha lut mos na lejoni me dërgu në Asamble në mënyrë të tillë një dokument pa qenë i kompletum edhe para qytetarëve dhe para kolegëve të tjerë në Asamble kjo është shumë e mangët,po besojë plotësishtë në punën e komisionit por nuk është e drejtë në këtë mënyrë me shku një vendim.

Flamur Bytyçi-pajtohem me para folësit e mi për çështjen e raportit,me qenë se raporti nuk është i kompletum nuk ka detaje për të cilat ne duhet me i pas para vetës unë konsiderojë që kjo çështje me u shty për një seancë tjetër,përshkak që ne duhet me diskutu me pa të specifikume për secilën rast për secilin dëmtim ne duhet me pa sepse ka të bëj me financa andaj ju kisha lut që këtë çështje ta shtyjme për një seancë tjetër.

Mimoza Bajraktari-përshendetje për të gjithë,krejt kjo qka po diskutohet për këtë raport është në rregull mirpo unë kisha kërku nëse e marrim shembull 30 familje secila lënd me i pas 3 fleta x bëhet shumë ma mirë kish me qenë qato familje nëse jan të amviserisë me qenë në excel edhe dëmi veç të bujqësis me përpilu një listë.

Dardan Berisha-ne jemi tu lyp raport nuk jemi te lyp specifikisht për secilën familje duhet me dallu raportin qka është ne kemi pasë raport këtu edhe me 300 faqe,realishtë nuk duhet me hek prej pikës se rendit ditës ne duhet me dërgu në Kuvend sepse Kuvendi është vendimëmarrës ne vetëm po e diskutojmë,qka vonohet është më keq për ato familje që presin një ndihmë prej dorës sonë.

Laureta Tafaj-një pyetje zonjës tha që mosi të votohet në Asamble ka m u konfirmu edhe një Komision për me u vlerësu cili ka me qenë roli

Avni Bytyqi-përshendetje për të gjithë,vrejtja e parë e jemja për këtë raport ke te çështja e raportit punës mbi vërshimet mirpo mosi u konsultova me kryesuesen e komisionit dhe më tha që ka qenë rekomandim nga komisioni qëndror ky emërtim apo titulli i këtij raporti.Çështja e këtij raporti ju e dini që thirrja ka qenë nga Komuna të gjith ata që kan pasë dëme të shkaktuara të bëjnë kërkesë dhe të paraqesin,dëshmi,fakte dhe argumente me qëllim që Komuna ta formojë një Komision dhe të del ti verifikojë dhe ta konstatojë gjendjen faktike në teren se a është bër ai dëm siq e kan para pa ata në kërkesën e tyre.Kryetari i Komunës ka themelu komisionin komfort legjislacionit në fuqi dhe komisioni ka përgadit një raport pune për të cilën po mrndojë ju si KPF dhe si Kuvend nuk jeni kompetent dhe prioritet ta ndryshoni atë raport që e ka bër komisioni për arsye se ky ka mandat dhe kompetent për ta bër vlerësimin e dëmeve ndërsa ju keni me miratu vetëm vlerën financiare të këtij raporti pa dyshu që ju mundeni me kqyrë kush ka qenë por nuk mundeni me bër vlerësim sa ka qenë kjo apo kjo se kompetentë për këtë çështje ka qenë Komisioni që u formu me vendimm të Kryetarit.

Flamur Bytyçi-në një nga çështjet që po shohim është bashkë në këtë raport gjendët e bashkangjitur edhe dosja e plotë në raporte të detajuar të vlerësimeve të dëmëve,dmth me qu në Asamble këtë ku vetë ju e keni shkru që është e bashkangjitur edhe dosja e plotë këtu nuk është dosje e plotë këtu është një dokument dhe unë për këtë arsye nuk po du me përkrah,kjo i bjen që ne e kemi miratu bashkë me dosje të plotë dhe këtu nuk është e plotë.

Kryetari-kërkesat i kan bë qytetarët dhe të gjitha janë të protokolune jo sikur në 2018 tash është më ndryshe qdo kërkesë është e protokolune dhe kan dal komisioni e kan vlerësu në krahasim me komuna tjerane nuk kemi pas dëme të mëdha,për me ja plotësu dëshirën të gjitha dosjet do të ju dërgohen në mënyrë elektronike.

Enver Shabani-përshendetje për të gjithë,veç komisionit komunës ,qeveria e ka formu një komision përkatësisht Agjensionin për menagjimin e emergjencave ata kan me bë rivlerësim nuk është ngarkesë për Komunën dhe nuk ka obligime financiare mos e merrni shumë përgjegjësi në këtë rast Asamblea është një lloj tranzicioni dhe duhet me kalu domosdoshmëri në Asamble për me shku në Agjencion.

Kryesuesi- e hedhë në votim si pikë shtesë të rendit ditës

Miratohet të futet si pikë shtesë

Kryesuesi-po e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

4 vota për,1 kundër 2 abstenime miratohet me pikën shtesë

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 1.

Unanimisht miratohet

Pika2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Kryesuesi-e elaboron pikën dy dhe hap debatin;

Laureta Fandaj-në praktikën e Komunës së Suharekës përbërja e këshillit siguris gjithmonë ka qenë me më pak anëtarë,pyetje ime është se a bazohet ky zgjerim në ndonjë ndryshim ligjor apo ndonjë udhëzim të ri?nëse po a mundet me naj prezantu atë ndryshim,sepse ne e dijm që numri popullësis ka ra,në bazë të qfar arsyetimi është rrit ky numër?

Avni Bytyqi-ligji për policin e Kosovës dhe udhëzimi administrativ i 2012 i nënshkru nga Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e Pushtetit lokal e obligon Komunën që ta themelon këshillin komunal për siguri në bashkësi i cili i ka të përcaktuar qështjen e përbërjes të këtij këshilli.KKSB një pjesë e këtij këshilli përbëhet me automatizëm dhe del nga institucionet që deshtëm apo sdeshtëm na e kemi obligim ligjor,një pjesë e anëtarëve të këshillit udhëzimi administrativ thotë që duhet bëhet një thirrje publike nga Kryetari i Komunës për ta plotësuar KKSB,ne si Komunë dhe unë si kordinator i këtij këshilli që kam qenë mandatin e kalum po besojë që edhe në këtë mandat ka me qenë kordinator i këtij këshilli në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ne kemi bë thirrje publike për ta plotësuar numrin e atyre që kërkohjet sipas udhëzimit administrativ dhe të gjith ata të cilët kan qenë të interesuar i kan bë propozimet dhe ne i kemi fut në kuader të këtij këshilli ndërsa ata që nuk kan qenë të interesuar e kemi bë përzgjedhjen ne si Komunë.Këshilli edhe në mandatin e kalum ka qenë në përbërje prej 20 anëtarëve apo 19 nuk dmth që përbërja e numrit banorëve është rrit apo është zvoglu të zvoglohet edhe numri anëtarëve të KKSB për arsye që këto rregulla i përcakton udhëzimi administrativ dhe ne po besojmë që ju kemi përmbajtë udhëzimit administrativ që e parasheh themelimin e KKSB-së.

Dardan Berisha-pajtohem se edhe ky Këshill është vetëm rekomandues nuk ka me marrë vendime,për me marrë vendime duhet me qenë tek jo çift jan 20 anëtarë të komisionit,vetëm deshta me bë një pyetje A ka të drejtë me qenë edhe anëtar i këshillit të komuniteteve dhe me qenë edhe në KKSB.

Avni Bytyqi-udhëzimi administrativ decitivisht e thotë që Kryesuesja e Komitetit për Komunitete njëkohësisht duhet të jetë edhe anëtare e KKSBB-së si dhe secili nga përfaqësuesit e Komuniteteve pakicë që jetojnë në atë Komunë duhet të jenë përfaqësues në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi me qëllim që ti mbrojnë të drejtat dhe interesat e qytetarëve të komuniteteve pakicë. Ne jemi mundu që ti përfshijmë të gjitha Komunitetet Pakicë në kuader të këtij Këshilli me qëllim që ti përmbahemi edhe udhëzimit administrativ që e parasheh.

Kryesuesi-e hedhë në votim pikën 2

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-pasi që ky vendim është kthi një herë në mungesë të qartësisht për interesin publik e jona është që me sqaru në detaje dhe me e gjetë një mënyrë të prerë para se me qu në Asamble ose edhe atje nëse veq e dërgojna, në raportin e komisionit thuhet se ka pasë vetëm një ofertues dhe ai ka marrë 100% pastaj % prej 21 sa është në interes të Komunës kjo se sot nuk ka më 21% sipas hulumtimeve jan 30-35% ku është interesi Komunës këtu ? dhe sa i përket kësaj garancionit të 10% të cilës shumë nuk është e përcaktuar. Prandaj po lus mos me dërgu në Asamble pa pas një pasqyrë të qartë se qka tash që është kthi prej Ministrisë cili është përfitimi i Komunës a shkon njëjtë.

Armend Krasniqi-përshendetje për të gjithë, deshta me u përgjigjë te një pyetje pasi që ishte në kompetencen time si Kryesuesi i atij Komisioni, është e vertet që është bërë me 21% mirpo në kuader të atij 21% përcaktohen kriterët, kriteret i përcakton një komision, komisioni formohet në Asamblen Komunale ku kan qenë të përfshira të gjitha partit politike dhe bashkarisht dhe unë si kryesues i komisionit edhe anëtar i LDK-së edhe anëtar i AAK-së edhe anëtar i tjetër i PDK-së kemi vendosur që ta qesim një bazë prej 21% fatkeqësisht kemi pas vetëm një ofertues dhe ai ka apliku me 21% dhe ka qenë përfitues i kësaj parcele.

Laureta Tafaj-fillimisht nuk ka qenë prej të gjithë partive komisioni i përbër, pyetja ime konkretisht ke 21% a është interes i Komunës apo nuk është? A e keni marrë përbazë hulumtimin e tregut sot apo vetëm e keni vendosë unanimisht në Komision?

Armend Krasniqi—kjo ka mujt me qenë me 50% por për fat të keq nuk ka pas konkurrencë. Komisioni ka kompetenca të vendosë qfarë do %?

Laureta Tafaj-un e di se kam qenë pjesë e disa komisioneve të pronave mirpo në këtë rast veq ju keni desht me vendosë 21% pa e hulumtu tregun që sot është një % me e lartë?

Armend Krasniqi-ne i kemi pas bazat paraprake që kan insistu me i marrë me 21% faktikisht tavani për 20% në bazë të asaj baze kemi qitë thirrje për konkurim të hapur me 20% psh kemi pas rastin tjetër kur thirrja ka qenë me 20% mirpo kan qenë dy ofertues njëri me 25% ndërsa tjetëri me 27%, ai me 27% e ka përfitu. Faktikisht këtu ka shku qdo gjë në rregull sipas ligjeve në fuqi sipas rregulloreve në fuqi dhe sipas të gjitha akteve tjera juridike të cilat kan kaluar edhe në Asamble.

Laureta Tafaj-a i keni caktu metrat ² të lokaleve apo banesave të cilat kan me u marrë?

Armend Krasniqi-Komuna e Suharekës është përfituese si kurrë më par në atë ndërtim i cili do të ndodhë shumë shpejtë.

Flamur Bytyçi-Këtë praktiken për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë po besojë që Komuna jonë duhet me ndal këtë çështje tu e marrë për bazë të kalumen kur na e kemi dhënë në shfrytëzim për 99 vite dhe Komuna ka marrë lokale banesa etj dhe si rezultat i kësaj Komuna tana herët është fut në borxh, tash na nëse vazhdojmë prap me i dhënë ne prap kemi me i shkaktu dëm Komunes, ka me marrë një lokal dy etj, mirpo prap kemi me pasë telashe. Unë besojë që Drejtoresha e Financave ka me na tregu sa është borxhi i qerave të papaguara i lokaleve që i kan marrë me qera në raste të njejtë, kështu që konsiderojë që kjo çështje në Komun me u ndal mos me u dhënë për 99 vite në asnjë rast në shfrytëzim përshkak që ti nuk po mundesh me e nxerrë borxhin. Unë vetëm për këtë

arsye jam kundër dhënjes në shfrytëzim dhe Komuna me këtë rast nuk përfiton kurgjo përkundërazi vetëm kemi me pas probleme në të ardhmen.

Armend Krasniqi- Flamur,nuk pajtohem me atë që Komuna nuk duhet me hy konsensiume të përbashkëta për me përfitu banesa lokale të ndryshme të cilat e pasurojnë shumë Komunën,psh nëse i fiton 100.000 banesa të cilat i përdorin për social dhe për qytetarë të vetë edhe Komuna e Suharekës unë mendojë që duhet me praktiku këtë jashtëzakonisht shumë dhe me rritë kapacitet në mënyrë pse mos me i bë 1000 banesa në pronësi të Komunës dhe me i shfrytëzu për raste sociale ,raste të veteranëve,familje dëshmorëve etj.

Flamur Bytyçi-a je detyru me i largu disa familje prej banesave,atëherë pse i ke largu?

Armend Krasniqi-kemi marrë iniciativë në të kaluarën ku i kemi largu nga banesat dhe tani i kemi përfunduar të gjitha procedurat ku ato banesa mund të ju afrohen familjeve të dëshmorëve .

Flamur Bytyçi-Sa është borxhi Drejtor? Unë tu bazu në këtë po them që po i shkaktojmë dëm Komunës,ju i keni largu ato familje nga banesa mirpo borxhin nuk ja keni marrë,as nuk keni marrë vendim si Komunë me i dërgu te përmbartuesi as një vendim nuk e keni marrë ky është shqetësimi im.Në rregull qysh po e thu ti ,por ju vetëm i keni largu dhe asnjë vendim tjetër nuk e keni marrë,as edhe me qeverisjen e re nuk e keni marrë asnjë vendim.

Dardan Berisha-nuk pajtohem me Flamurin në një pikë sepse ne kemi parcela të Komunës që jan 3 ari,6 ari nuk mundesh mi shfrytëzu kurrë kështu që ky konsensium është i domosdoshëm mu përfunduar kjo pjesë sepse ka partneritet publiko-privat të cilët dojnë me ndertu edhe pamvarsisht ndonjë aktivitet tjetër që dojnë me ushtru,me 3 ari vendo ose 6 që i ka Komuna ti mundesh me përfitu shumë.

Sanie Kuçi Rexhepaj-pak me u ndërlihd te fjala e Drejtorit që tha kemi marrë praktika nga konkurime të hapura të më hershme,këto praktika ndoshta është mirë me fillu me i ndryshu Drejtorë përshkak se ato praktika kan qenë para 10 ose 20 vite dhe koha ka ndryshu kogja shumë.Ne jemi duke fol për një konkurim tashmë të përfunduar përshkak se ne vet si Kuvend ja kemi dhën besimin atij komisioni për me e percjellë dhe me sjellë kët raport sa i përket këtij konkurimi të hapur.21% nuk është vlerë që e tregon interesin publik dmth Komuna nuk është tu fitu me 21% përshkak që ka kapacitet me fitu më shumë se qajo vlerë por është një punë që tashmë eka përfunduar komisioni dhe tash ne vetem jemi duke diskutu dhe është çështje e përfundime ama duhet me u ndryshu në konkurimet e tjera të hapura qekjo praktik e 21% përderisa marrin kontrata që jan te noteri që mundemi me i siguru pa asnjë problem dhe shohim që % sillet rreth 30-35% atëher kur komisioni mblidhet dhe e hap konkurimin e hapur për një parcelë të caktume atë prapun e 21% që e keni caktu ju atëher si komision duhet me kërku dhe me ndryshu.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 3

5 për,1 kundër,3 abstenime miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-Natyrisht që komisionet janë pjesë përbërese dhe duhet me qenë patjetër,por në mandatin e kalum asnjëher opozita nuk është përfshi në komisione.Kryesues dhe Kryetar mundeni me marrë si kërkesë nga ana ime që komisionet të formohen nga pozita edhe opozita,unë e kuptoj që jeni dy parti në pozitë edhe AAK edhe PDK mirpo ju lutem vendosni ni të përbashkët për me marrë pjesë në komision psh në këtë rast munden 4-5 për dhënie në shfrytëzim edhe për mbikqyrje mos të jetë të pozitës edhe në shfrytëzim edhe në mbikëqyrje,kërkoj bashkëpunim nga ana juaj.

Dardan Berisha-nuk dua të pajtohem me një pikë me Laureten sepse ne jemi subjekte të ndryshme politike nuk ka të bëj kush e udhëheq kush jo,ne jemi PDK dhe i kemi 5 asambleist kështu që kjo shkon bazë numrit të partive nuk shkon në bazë të numrit të atyre që qeverisin.Unë pajtohem me Armendin që tha edhe opozita ka qenë e përfshime në komision ,kemi me ardhë tek pika e fundit te raporti i komisionit për zona ku 3 herë Kryetari bashkë me Kryesuesin e kan pru pikë të rendit ditës me formu një komision edhe me dal në Zonën ekonomike dhe asnjëri nga subjektet politike nuk kemi propozu anëtar të komisionit për me dal mu marrë me problematika të zonave.

Laureta Tafaj-Nëse jo të tjerët unë edhe Dardani jemi për të trretën herë bashkë në Kuvend,nëse në mandatin e par kam qenë krejt e re edhe kam marrë pjesë në komisionin për ujë në Vraniq dhe Budakov kjo tregon që atëher nuk kam dit me u tut e leje më sot.

Sanie Kuçi Rexhepaj- edhe në mandatin e kalum e kam shprehë si propozim,dhe po e shprehë edhe në këtë mandat,nuk e di pse nuk lejohet që kjo praktika që në momentin që ne e japim pëlqimin për me e dhën në shfrytëzim një parcelë për me dal në ankand publik ose konkurim të hapur cila do qoftë forma mos me u miratu komisioni në atë seancë dmth me qenë dy pika të rendit ditës,e para me qenë të jepet pëlqimi për dhënjën në shfrytëzim me afat të shkurt apo të gjatë dhe pika tjetër me qenë formimi i komisionit,përshkak që po hup shumë koha po duhet dmth nëse qajo parcelë jepet sot në shfrytëzim po duhet tek mbas 1 muaj ose 2 muaj me u formu komisioni për me i zhvillu qato procedura të ankandit publik apo konkurimit të hapur nuk po r kuptoj pse nëse nuk miratohet nga Kuvendi pika për me u dhën në shfrytëzim ajo pron e caktume nuk miratohet as pika e komisionit nuk e di pse nuk e perdorim si praktik.

Kryesuesi-ti e din shumë mirë që vendimet tona shkojnë në MAPL për rishqyrtim të hapur,mund të ndodhë që ata e gjejnë një . ose , që i mungon e kthejnë në rishqyrtim.

Sanie Kuçi Rexhepaj-rishqyrtohen të dyja për mos me humb koh,përshkak të përfituesve,sepse në shumicën e rastev vini me vendime urgjente se duhet me shpejt me fut në fuqi,vetëm për çështje kohe.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 4.

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-ky komisioni për shqyrtimin e ankesave a është për qdo ankesë që vjenë apo është për një rast të caktum,sepse kjo pjesa e projekt-vendimit tkalum na e ka përzij pak çështjen prej kur u miratu ligji në vitin 2019 ndryshimi i ligjit për dhënjën në shfrytëzim të pronës pak këto çështje na kan dal prej durve.

Avni Bytyqi-ligji e parasheh siq e permendem më herët kur jepet pëlqimi për dhënjën në shfrytëzim pronës publike Komuna ka për obligim të themeloj një komision për secilën parcelë, ndërsa te çështja e komisionit për shqyrtimin e ankesave ligji dhe rregullorja e parashehë që ky komision të ketë mandat 2 vjeçar,dhe në monetin që i përfundon ne jemi të obligun që ta themelojm komisionin tjetër.

Flamur Bytyçi-tek çështja e afatit,ky komision ka me pas vetëm dy vite mandat,a nuk mundet me u bë 4 vite aq sa është mandat

Dardan Berisha- anëtarët e komisionit themi që jan të zgjedhur kemi drejtë të njejtit prap me i përsërit psh është vendim ndryshe ne e kemi pas një anëtar të komisionit 4 vite dhe e kemi propozu qdo vendim të njejtin anëtar kështu qe ne kemi të drejtë ke propozu të njejtin anëtar të komisionit për qat komision.Për 2 vitet të tjera ne mundemi me propozu të njejtit anëtar.

Kryesuesi- e hedhë në votim pikën 5

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacioni i Autobusëve”;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj- para se me votu për këtë pikë,mandatin e kalum ne Asamble me një grup të veçantë kemi votu që pagesa,meditje e këtyre anëtarëve me qenë 200€,tash me këtë të rejen është 50€,nëse ka me qenë 50€ a ka mundësi fillimisht ju me pru për shfuqizim atë 200€ në Kuvend.

Kryesuesi-ka ra poshtë ai vendim sepse ka qenë me mandat,dhe i ka skadu mandati.

Flamur Bytyçi-a ka mundësi me u rritë numër i përfaqësuesve të Kuvendit?

Avni Bytyqi-neni 5 i ligjit për ndërmarrje publike decitivisht e thotë ashtu siç e kemi cekur në vendim,2 nga Kuvendi 1 nga Ekzekutivi.

Enver Shabani-këtë shumën 50€ kush e përcakton?

Avni Bytyqi-ndër Komunitat e para që i ka kompenzu të gjitha komisionet qëjan themelimi nga Kuvendi është Komuna e Suharekës,para se me caktim këtë takim unë e kam pas një takim me Kryetarin dhe e kemi diskutuar çështjen e kompenzimit për anëtarët e komisionit që themelohen nga Kuvendi përshkak që kemi pak problem me buxhet dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm dhe Komuna ka nevojë të themelon komisione të mjaftueshëm dhe besoj ndoshta nuk ka mundësi buxhetore dhe komunalimi mi kompenzu të gjitha këto komisione,dhe ne kemi menduar dhe vlerësojmë që një vlerë prej 50€ është një vlerë simbolike që edhe ndoshta pak a shumë është e kapshme edhe për anëtarët e komisionit por e përballueshme për buxhetin e Komunës në ekvivalent vlerës që të jetë 50€ por me kërkesën e juaj është në mandatin juaj që ta vlerësojmë edhe më tepër por mendonim që mund të me u paraqit rrezik edhe buxhetit Komunës për arsye që ka shumë komisione në vazhdimësi.

Enver Shabani-unë e bëra këtë pyetje,mirpo unë besoj që komisioni duhet me u financuar nga Stacioni i Autobusëve nga buxheti i Komunës,dhe besoj që ata i kanë mundësitë për me financuar këtë komision.

Avni Bytyqi- e ka rrezikun e të hyrave vetanake,me ligjin për ndërmarrje publike ata e kanë nifur lloj devidente që duhet ta dorëzojnë në Komunë por përshkak të gjendjes ekonomike financiare që e kanë jo të mirë,Kryetari i Komunës ka thënë që veç mbijeton se nuk ka nevojë me prur devidentin në Komunë për arsye se nuk e kanë gjendje ekonomike financiare të mirë përshkak të krizave që po ndodhin.

Flamur Bytyqi-një replikë për Avniun tek çështja e pagesave,ka pas komisione në të kalmen të cilat nuk janë pagu dhe kisha dashtë shumë mirkuptim prej juve që secili komision me u pagu dhe ka mjete,po nisja prej raportit të shpenzimeve 400€ është fatura mujore e telefonave mobil veç prej zyrës së Kryetarit,dmth paska mundësi dikun me u shpenzu 400€ e spaska mundësi me u pagu një komision për një punë të cilën e kryen,këto arsyeime që po jepen këtu para neve po besoj që nuk qëndrojnë,mundesh me rrit nga 50€ edhe 100€ dmth ka mbulueshmëri financiare sa don,vetëm i ulë koston e shpenzimeve tjera, ulë telefonit mobil i ulë drektat darkat zyrtare,pije,dhe ti e mbulon pjesën e komisionit pa asnjë problem.

Avni Bytyqi-Komuna ka një kontratë me valën dhe të gjithë puntorëve të administratës u a jep nga 2€ dhe rritet ajo fatura e telefonisë mobile dhe tani po mendojnë që po shpenzon Kryetari apo Kryesuesi,janë në total 200 apo 300 punëtor që marrin.

Flamur Bytyqi-unë e përmenda vetëm zyrën e Kryetarit i ka 400€ pa i hy secilës Drejtori tjetër,unë për këtë po them se na mundemi me gjetë formë,për arsyeshmëri financiare mundesh me i ulë shpenzimet tjera për me i mbulu komisionet.

Laureta Tafaj-pyetja që po du me e bë ka të bëjë me stacionin e autobusëve por jo pikërisht me temën,me dashtë me bë një emërtim të ri të stacionit të autobusëve a duhet me ju drejtu komisionit të cilit ka me u formu apo dikun tjetër sepse kam një propozim që ky Stacion me u emërtu me emrin “Ushtarë Kavaja” ose “Indrit Cara”

Kryesuesi-Stacionit të autobusëve në nivel të Kosovës asnjë emërtim tjetër nuk e kanë pos Stacioni i Autobusëve.

Avni Bytyqi-me ligj nuk e ndalon,mundesh me adresu,komisioni tash që themelohet ai ka kompetencë që ti shqyrton të gjitha kërkesat sepse është përbërja edhe nga Kuvendi edhe nga Ekzekutivi dhe ata vendosin dhe Kuvendi e miraton.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Eko-Regjionin”;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-deshta me pyet që nëse edhe kolegët e mi e mbajnë mend,që komisionet paraprake kanë raportu ndonjëherë në Kuvend për punën që e kanë bë,dmth nuk kanë prezantuar asnjëherë raportin në Kuvend për dallim nga Stacioni i Autobusëve që e kanë bë qdo herë.

Sanie Kuçi Rexhepaj-po ndërlihdna pak me pyetjën Lauretës për faktin se në mnadhin e kalim kam qenë pjesë e komisionit,edhe në KPF edhe në Kuvend e kam parashtrur si kërkesë që me u

bledh ky komision përshkak që nuk u ftu asnjëher nga ana Ekzekutivi ,krejt qysh kan funksionu në të kalumen.Edhe në KPF disa herë e kam potencu edhe në Kuvend nuk ka pas as edhe një ftesë për 4 vite.Kështu që u lidha edhe pak me çështjen që tha Laureta edhe arsyen pse nuk kam me votu sepse nuk është punu.Meqenëse sa e kam kuptu e meta e komisionit paraprak ka qenë që të gjithë anëtarët e komisionit kan qenë anëtarë të Kuvendit,psh në mandatin kur Enveri ka qenë Drejtorë edhe ai e ka ftu komisioni dhe mandej ka qenë edhe Kryesues i komisionit.Në mandatin që ka kalu jemi qenë te 3 anëtarë të Kuvendit,dmth ky propozimi i emëruar nga Kryetari i Komunës prap ka qenë anëtar i Kuvendit e jo i Ekzekutivit,e mangët përshkak se 3 anëtarë dhe asnjani nuk e ka ftu njëri tjetrin.

Dardan Berisha-tu e ditë që Eko regjioni i ka 13.1% tëaksionëve si Komunë a ka me ardhë edhe një komision i ri për Eko-Therandën?

Kryesuesi-Po

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi-unë e kam jë kërkesë për drejtoreshën,nëse ka mundësi me na tregu se pe shoh prej shumcës së projekteve që këtu jan,janë marrë pare prej përmbaruesit,sa është borxhi që e kemi na punëve që jan kry prej kontratorëve.Nëse mundët në seancë me na ardhë me ni raport me na tregu sa është obligimi që ka Komuna e Suharekës ndaj operatorëve ekonomik nga të cilat mjete jan marë prej përmbaruesit privat,psh në një rrugë të caktume ka qenë e planifikume 200.000€ 100.000€ jan marrë nga përmbaruesi edhe sa i kemi borxh ne.

Fadil Hoxha-përshendetje për të gjithë,materialin që e keni marrë për raportin administrimit të buxhetit janar-dhjetor 2025 i keni edhe projektet kapitale që ju kom premtu edhe më heret që ka me i fut në secilin emër në secilin kod se sa është shpenzu sipas vendimit gjykatës,përveq shpenzimeve të rregullta që janë e keni edhe një tabelë në fq 21 për vitin 2025 gjithsej sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar komunal 188.629,86€ mallra shërbime 605.387,92€ subvencione 146.851,19€ kapitale 2.142.028,63€ që i bije në total 3.082.897,60€.I kam vendos edhe 2023 pa i përmend me projekte kapitale se kto kan qenë edhe më heret kur i kam qit edhe vitet e kalume kur ka përfundu vitit fiskal.2023 në total është 608.372€ ku jan edhe kategoritë tjera,komunal,mallra shërbime nuk i kam nda por i kam qit si shumë totale dhe 2024 është 4.133,000€ dhe i keni pas të ndame besojë që e dini,që i bje në total 2023,2024,2025 7,825.126.86€,tek projektet kapitale në fq22 i keni shpenzimet kapitale për periudhen janar-dhjetor nga vendimet e gjykatave,ku janë të cekura nëpër secilen Drejtori dhe secilin projekt që është prekë konkretish rregullimi dhe ndërtimi i varrezave në Biraq,230.000€ është buxheti 182.000€ jan shpenzu vendimi i gjykatave,tek pjesa e fundit ku e kam shkru buxheti i shpenzuar me fatura këtu ka mundësi që është shpenzu ose nuk është shpenzu por është tabela tjetër që tregon se ky projekt sa është shpenzu.tek fq15 i keni projektet që jan bë shpenzim se ju gjithë herë keni thën qysh po thoni është bë shpenzim ku asnjë send nuk është bë dhe për atë e kam marrë obligim me jav nxerrë edhe vendimet e gjykatave për secilin projekt sa është shpenzu.

Flamur Bytyçi-nuk po e kontestojë çështjen që po e thu ti por tash psh për secilin projekt dikun i ka marrë 182.000€ dikun 40.000€ sa është obligimi jon ndaj operatorëve kontratave të nënshkrume që i kan kry punët.

Fadil Hoxha-ato nuk mundem me ditë se nuk e dijm qka ka ndodhë me kontrata projekti si projekt është i buxhetum,psh ky 230.000 është i buxhetum kontrata mundet me qenë 2 vjeçare ato jan shumë relevante,problemi është sa ka qenë buxheti,sa u shpenzu buxheti,au shpenzu me fatura apo u shpenzu me vendim Gjykatave.

Flamur Bytyçi-pyetja ime o kjo Sa është obligimi jonë që i kemi prej ktyre që i ka marrë përmbaruesi?

Fadil Hoxha- me këtë raport nuk mundesh me ditë sepse nuk e kërkon.

Flamur Bytyçi- me leje kërkoj prej DEFB me prurje një raport në Asamble sa është obligimi jonë i Komunës ndaj operatorëve ekonomik .

Avni Bytyqi-për me i ndihmu Flamurit,Fadilit dhe Drejtoreshës kjo pyetje duhet me ju adresu Drejtorisë për Shërbime publike ajo duhet me pas saktë deri ku kan përfunduar punimet,ku kan mbetur obligimet e Komunës.Drejtoria e Financave nuk ka të dhëna të sakta deri ku kan përfunduar kontratat.Nëse ka obligime ata i bëjnë faturat.

Flamur Bytyçi-kur u krye një situacion apo një projekt,ju a e keni dërguar në Drejtori të Financave për pagesë,Drejtoria e Financave po besoj që duhet me i pas këto shënime nuk është vetëm Drejtoria Shërbimeve Publike përgjegjëse.

Enver Shabani-Nuk është e vetmja Drejtoria e Shërbimeve publike që ka investime kapitale,para përfundimit të vitit kalendarik data 24-25 të gjitha punët e kryera dhe në mungesë të mjeteve si borxh deklarohet në Drejtorinë e Financave,unë besoj si Drejtori i kemi të gjitha dhe duhet secila Drejtori mi pas shënimet dhe të gjitha duhet me i deklaruar si borxh apo obligim në Drejtorinë e Financave.

Sanie Kuçi Rexhepaj-nga praktikata e kalime,nëse unë kam qenë pjesë e një kontrate mbikëqyrëse se tash e di që kan ndryshuar termet por nëse është përfunduar puna unë maspari kam kërkuar nga Drejtoria e Financave alokimin e mjeteve,pa alokim të mjeteve unë nuk kam mundësi me percjellë faturen të Drejtorisë e Financave,e tash nëse nuk ka mjete unë skam qysh me aloku dhe nuk mundësi me dorëzuar faturë.Deshta me u ndërlidhë pak me atë që e tha edhe Flamuri për këto raportet e shpenzimeve vjetore të vitit kalendarik janë pak a shumë si shabllone që po plotësohen komplet dhe qashtu vetëm po dorëzohen dhe qekjo është praktika që aplikohet secilin vit,mirpo viti prej vitit po ka shumë dallim për vitet e fundit kemi pasë çështjen e përmbaruesit që ka qenë pak ma specifike ndoshta me e thënë prej viteve të tjera dhe gjithmonë është shtruar si pyetje ose si kërkesë sa mjete i ka marrë përmbaruesi? Cilat projekte janë prekë? Përshkak se qeky raport po dorëzohet në Kuvend Kryesues dhe po miratohet,tash po e marrim mas disa viteve që po e lexojmë këtë raportin dhe po shënon që ndërtimi i sallës sportive në Peqan janë shpenzuar qekaq mjete por salla nuk është kërkuar,dmth qajo po lind ? janë shpenzuar mjetet por salla nuk është,në asnjë pjesë nuk shënon si klauzol ose si shënim shtesë që këto mjete nuk kanë shkuar për projektin në fjalë por kanë shkuar për Përmbarues,dmth kur përgaditet një raport duhet me u ditë ku kanë shkuar ato mjete.

Fadil Hoxha-Unë ju thash që e keni të veçantë tabelën dhe shiqoni ku thot shpenzimet kapitale për periudhën janar-dhjetor vendimet e Gjykatave përsecilin projekt është pjesa e procesimeve që nuk është bërë shpenzim në mënyrë të rregullt por me vendim të Gjykatave.

Flamur Bytyçi-du me u kthyer edhe njëherë te raporti i shpenzimeve ndoshta ju doket e pa rendesishme por unë po e shohë gati në secilën Drejtori shpenzimet për vitin e kaluar te telefonat mobile secila Drejtori i ka të shpenzuar ka 2000€ për 1 vit vetëm Zyra e Kryetarit i ka 5000€ unë nuk po e kuptoj që ka është ka shpenzohet qekaq shumë dmth për një faturë mujore 400€ vetëm te Zyra e Kryetarit pa i përfshirë Drejtorit tjera unë nuk e di që o ka ndodhë kush mundet me marrë një shpjegim që ka është ka shpenzohet,Komuna e Suharekës apo ja paguan të gjithë qytetarëve telefonin mobile apo që?Është shpenzim enorm kjo për mu.

Fadil Hoxha-Është një vendim i Kryetarit që disa prej Zyrtarëve kanë mbushur të telefonave,përveq kryetarit kanë Drejtorat dhe disa prej zyrtarëve,kur mbledhen këto aty e ki shumën totale për krejt vitin.Nëse llogaritet Kryetari nuk ka limit të Kryetari hyn:Nëse llogaritet Kryetari nuk ka limit të Zyra e Kryetari hyn:Nënkryetarja ,Kryesuesi,Prokurimi dhe disa prej zyrtarëve dmth janë 6-7 që kanë mbushur dhe është vendim i Kryetarit që ju ka dhënë mbushur Zyrtarëve në fjalë.

Flamur Bytyçi-unë nuk po e kontestoj çështjen e vendimit por po e kontestoj që është shpenzim enorm për secilën Drejtori.

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 9 Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Raportit të komisionit për mbikëqyrjen e kontratave në zonën Industriale në Shirokë;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-unë po e shoh këtu komplet një raport që ne po e diskutojm po du me përgzu komisionin që e ka kry një punë të jashtëzakonshme edhe Armendin du me falenderu,një çështje që mu po më shqetëson është që qe ky dokument nuk është i plotë,në faqen e fundit është edhe një vendim për të cilin unë nuk po e shoh raportin e këtij vendimi ku autorizohet me ligj obligohet komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave a ban me pa na këtë raport ket vendim të këtij komisioni dhe pse nuk është i nënshkruar ky raport,kush mundet me na dhën sqarim unë kisha dashtë që këtu me qenë edhe Kryetari sepse çështja e Zonës është ekzkluzive menaxhohet prej Zyrës Kryetarit ose prej personav përgjegjës kan e ka caktu Kryetari. **Armend Krasniqi**-Është me të vertet një punë jashtëzakonisht e mirë e cila është bër nga komisioni i caktuar nga Zyra e Kryetarit përshkak që Asamblea Komunale nuk ka pranuar një vendim të till për me ba monitorimin e Zonës Industriale,ne e kemi përgadit një raport dhe e kemi dorëzuar në Zyren e Kryetarit për të vazhduar me procedurat e më tutjeshme mirpo siç shihet ka probleme të ri pas vitit dhe vazhdimisht është një problematik shumë e madhe ku shfaqet dhe po mendojë që kjo duhet me shku në Asamble dhe përmes Asamblesë me ju vazhdu operatorëve ekonomik të cilët nuk kan mujtë me i përmbushë kërkesat të cilat i ka pas sipas ligjit dhe në kuader të kësaj me vazhdu më tutje,përshkak se nëse vepron Kryetari në bazë të këtij raporti me siguri duhet me u shpëput shumë kontrata dhe probleme të më tutjeshme nuk dihet se si mundet me ja dal,përshkak se investimet e mëdha të cilat jan bër dhe kontratat unë mendojë që nuk janë parapa në mënyrë përfekte se si duhet të veprohet pasi ti merret dikujt një parcelë.

Flamur Bytyçi-Armend unë e kam lexu detajisht raportin dhe për atë të përgzova për punen që e keni bër,tash këtë qka po e thu ti në fund na me bër me marrë vendim është e jashtë ligjshme për me ja vazhdu dikujt,i ki 10 kontrata shpëputne,i ki ndërrim destinimi,shitje,qka keni me bër na tash me ja vazhdu edhe për 1 vit,a e dini që 9 vite nuk ka pas komision për këtë punë,e keni themelur ni komision ,as sot nuk ka komision,është themelur edhe një komision tjetër që nuk ka raport për këtë çështje,keni shku edhe në Prokurori për këtë çështje bre,qka doni me bër hala me vazhdu me keto a,nëse doni me rregullu këtë çështje ju duhet me i shpëput kontratat,ma mir është me shpëput kontratatën për deri sa i kemi edhe 30 kërkesa tjera tu prit në rend për me marrë tok.10 kontrata të shpëputne kqyre ku e ki ligjin për dhënien në shfrytëzim mbikëqyrja e kontratave Drejtoria përkatëse e Komunës pas raportimit qdo 6 muaj nga Komisioni Kryetarit duhet me marrë vendim për me i shpëput kontratat.A ta bëj një pyetje a ka komision Zona sotë?

Armend Krasniqi-hala nuk është formuar por besojë Drejtori ri duhet me marrë iniciativ shumë serioze dhe me formu që nga dita sotit.

Flamur Bytyçi-nuk ka komision Zona sotë,nuk pas as në të kaluarën,prej vitit 2014 nuk ka pas komision.dmth i keni 10 kontrata të nënshkrime sot ju po lypni me ja vazhdu edhe për 1 vit dikujt që as edhe një baski nuk e ka vendos aty,a e dini kujna mundemi me ja vazhdu ai që i ka temelet jo dikujt që nuk ka punë kurgjo.Na me këtë kemi me rreziku dikan secilin zyrtar këtu qe e ki,dikush ka me shku në burg për këtë çështje,unë po besojë që ju jeni të vetëdijshëm për këtë.

Armend Krasniqi-unë pajtohem me këtë qka po e thu absolutisht është gjendje kautike dhe për këtë ne kemi vendos me dergu në Asamble në mënyrë që me gjetë një zgjidhje se si të veprohet më tutje.

Flamur Bytyçi-nuk ka zgjidhje,shpëputni kontratat,cila është zgjidhja,kqyrni borxhet që i keni.

Armend Krasniqi- psh e kemi Etiken ka investim 4.000.000€ me kontrat e ka të shpëputne në vitin 2009.

Flamur Bytyçi- e ka plotësu kriterin e ka legalizu nuk keni shku,dhe ai ka bër kërkesë për me regjistru për me pagu taksë,pse ju nuk keni shku,dhe ja keni legalizu objektin.unë për këtë çështje po kërkoj Kryetari me qenë këtu,se ne po diskutojmë pa personin përgjegjës dhe ai duhet me qenë këtu.

Kryesuesi-Flamur plotësisht pajtohem me mendimin tënd,shpesh kërkohet një raport për zonën,së paku ky raport të shkon në Kuvend dhe të diskutohet,le të shihet situata se si është në Zona.

Flamur Bytyçi-raportin e ka prur në fund të seances Armendi dhe ne e kemi lënë që këtë çështje me diskutu në seancë të jashtëzakonshme,njëkohësisht kërkova në fillim na po e lem këtë çështje me diskutu në seancë tjetër ose të jashtëzakonshme,është çështje shumë e ndihshme ,njerëzit jan tu shku në Prokurori dhe hetuesi mos vazhdoni me bër hajgare me këto sene,nëse doni me i kry punt dikujt hajdeni urdhëroni,po nëse doni veq me kamofllu me i dhën afat dikujt që nuk ka punë kurgjo unë

nuk jam i pajtimit. Se ne këtu po folim sikur mos me jetu në Suharekë, qe ju është zona ne të gjithë kalojm anej qdo ditë. Ju e keni pas vendimin për shkëputjen e kontratave, ppse nuk keni vepru, 9 vite nuk keni pas komision as tash nuk keni.

Armend Krasniqi-Për atë edhe e kom pru me monitoru si problematik, edhe pse të tjerët kan thën që nuk ban me perfundu sepse është gjendje kaotike, mirpo un e kam përfundu dhe e kam sjellë në Asamble dhe te Kryetari e kam pasqyru një gjendje reale e cila gjendet në Zonë, në bazë të asaj gjendjes reale ne duhet të veprojmë, mirpo me koefidencat e mia gtë cilat ikam pasur edhe si Drejtor edhe si Kryesuesi i komisionit unë kom vepru deri në atë pikë, tash Zyra e Kryetarit duhet me hartu mirë, unë po e konsideroj që duhet me diskutu me një seancë të jashtëzakonshme sepse është problematika më e madhe në Komunën tonë. Duhet me marrë seriozishtë këtë çështje bashkarisht dhe me gjet një zgjidhje të mirë. Unë e kam bënë një punë që nuk ka gxu askush deri sot me ba.

Flamur Bytyçi-për atë edhe të thash të përgëzoj për punën dhe për atë e ki mbështetjen tem sa her që e bën një punë të mir mu mbrama me ki, por qka nuk po pajtohem është qka dojmë me ba na me kete raport, unë konsideroj që na nuk kemi qka diskutojmë më teper veq me marrë masa komfort ligjit e thotë Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit merrë masa përkatëse dhe ai nuk ka marrë masa, dhe unë nuk jam i interesuar si Asambleist me shku me votukëtë dhe me shku në burg ose në Prokurori me dhën deklarata. Në momentin që ti e bjen vendimin me ja vazhdu edhe për 1 vit secili nga ne kem përgjegjësi bashk me Zyrtarët që merren me këtë çështje.

Armend Krasniqi-këtu ka kalu përtej çdo parashikimi të çdo ligji që egziston edhe për dhënjën në shfrytëzim sepse është një problem shumë i vjetër.

Laureta Tafaj-mos me u zgjatë shumë unë pajtohem me Flamurin për ato qka i tha, Armend përgzime kaq është për juve komisionin dhe këtu përfundon mandati juj nuk keni qka me ba më shumë dmth nuk mundeni me marrë vendime për atë mirpo këtu po shkrun kush mundet me marrë vendim është Kryetari në rast se komisioni konstaton pa rregullsi në zbatimin e kontratave ti rekomandojë Kryetarit të Komunës për veprime të mëtutjeshme ndërprerjen e kontrates dmth kush paska pas me marr vendim për me i nderpre paska qenë Kryetari dhe ai se ka marrë ai bie kështu dhe tash po ja gjun Asamblesë që me dal ai i paster dhe me thën që un nuk ja kom nderpre por Asamblea, Kuvendi përnime nuk mundemi me i kalu keto, ose ta lëm ne ndonjë seancë tjetër paraprakisht të marrim ndonjë vendim paraprak. Borxhi deri në 50.000€, u ndrru destinimi tokës ,u dhën qera mbi qera kjo hiqe se hiq nuk ban me u bënë ka probleme serioze, pse Asamble me marrë vendim. m

Sanie Kuqi Rexhepaj-edhe unë jam për vlerësim për komisionin për raportin që e ka punu, mirpo jo specifikisht veq për armendin se Armendi u kan pjesëtar i komisionit dhe kan punu si ekip, e këtu nuk të përgëzojë apsolutisht në asnjë pikë përshkak se e keni neglizhu komplet një detyrë që Drejtoria jote e ka pas për detyrë me monitoru të paktën kontratat që lihen gjatë mandatit tan si Drejtor kështu qe monitorimi në drejtorin tane ka dështu Drejtor, çështja tjetër është pak të nderlidhem em faktin që e permendi edhe Dardani edhe Armendi çështjen që Kuvendi ka refuzu me qenë pjesë e komisionit po e citoj qka thotë qarkorja ose udhezimi administrativ thot Drejtoria harton raportin për ecurin e zbatimit si dhe realizimin e kontratës në tërsi duke i rekomanduar Kryetarit të Komunës marrjen e masave përkatëse në rast të mos përmbushjes së kontratës dmth nuk ka qenë obligim i Kuvendit por i Drejtoris me hartu at raport, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit merr masa përkatëse ndaj investitorit me qëllim të përmbushjes së Kontrates. Raporti në këtë form që është sjellë ma mir se sa hiqë normal në disa çështje ka mund me qenë më i detajun sepse nuk është secila kontrat e njejtë me tjetrën, Zona industriale në Shirokë sa herë që po flasim është njera prej zonave më të zhvillume në Kosovë e marrim si shembull mirpo kur e lexojmë këtë raport po e shohim një kaos mbrenda për mbrenda zonës, biznese të cilat nuk kan kontrat të lidhur me komunën dhe operon në zonën Industriale , kemi biznese që operojnë jan aktive dhe janë b orxhli ndaj Komunës, kemi ndrrime të destinimeve dmth nuk e di qka tjetër vetë kto duhet të jenë keping institucional, një forcim ndoshta kisha thën te procesi monitorimit , përshkak se Komuna e Suharekës është e ndryshume në secilin aspekt sa i përket monitorimit ne kete rast të Zonës industriale mirpo edhe monitorimit të çështjeve tjera që i kemi diskutu disa herë. Nëse nuk veprojmë me hapa të caktumë, atëher njera hallkë që po shkëputet po krijonë komplet kaos dhe kërkush nuk po merrë përgjegjësi, kjo përgjegjësi në mbikëqyrje të kontratave që jan në zonën industriale është e kahmotëshme atë e dijmë mirpo që 10 vite nuk është marrë as një mas

edhe këtë e dijmë,kemi raste kur nuk është zhvillu asnjë investim dhe ndoshta me ato kontrata është më së lehti,sepse nuk është zhvillu shkëputet kontrata vazhdon tjetri,por qka me ju bë atyre që kan zhvillu dhe kan zhvillu kunderligjshëm sepse skan as leje ndertimore por as nuk jan tu operu vetë jan tu operu 2-3 biznese në atë parcelë,propozimi im është që Kryetari në këtë rast me hartu një plan të veprimit,duke i kategorizu secilin rast që thojm ne mos me u bë për dikë Nën e për dikë Njerkë,por me i pa ato kontrata qysh jan zbatu dhe vendimi me qenë për të gjithë i barabart dhe jo për dikan ndihëmes dhe për dikan ndëshkim,përshkak se ne si Asambleist dhe si Kuvend nuk është se duhet me i ndeshku bizneset qëllimi jonë parësor duhet me qenë me zhvillu zonën Industriale me ju dhën mundësi për zhvillim dhe jo ndeshkim sepse shkëputja e kontrates është opsioni i fundit që mujna me bo,nëse kena mundësi për me zhvillu,cili është opsioni që mundemi me zhvillu,me ndërmarrë masa se edhe bizneset nuk kan faj kan shfrytëzu neglizhencën e Komunës,as borxhet nuk i kan pagu ndoshta sju ka shku as edhe fatura për pagesë,krejt qka deshta me diskutu kët formimin e komisionit fundit që e përmendi edhe Flamuri që tha që nuk është nënshkru,autorizohet njëherë të obligohet komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës për mbikëqyrjen e Agro Zonë sipas raportit me numer protokolli të gjithë operatorëve ekonomik që veprojnë në zonë Industriale në Shirokë të cilët nuk e kan përmbushur kontratën të merren masa përkatëse ndaj nvestitorëve,vërejtje me shkrim,njoftime me qëllim të përmbushjes së Kontratës,unë nuk po e kuptoj Kryetarin pse po mundohet me i ik përgjegjësis së vetë,e di që është një detyrë e ndihjshme por është Kryetar Komune,nuk e di pse opomundohet me ja lan përgjegjësin dikujt tjetër por është përgjegjësia te Kryetari Komunës me marrë masa ai është nënshkrues i kontrates me operatorët ekonomik.

Avni Bytyçi-komisioni ka pas obligim që ti rekomandojë Kryetarit Komunës për secilen kontrat për veprimet më tutjeshme,ky komision në bazë të këtij raporti nuk i ka rekomandu Kryetarit qka me ba.

Flamur Bytyçi-pse me i rekomandu ku ai i ka tregu gjendjen faktike si është.

Armend Krasniqi –faktikisht për rregulloret dhe ligjet e pronës që i tha Drejtoria i monitoron neni 27,përgaditja e raportit agro Zon në zyren e Kryetarit ne kemi pas raporte të vazhdueshme për secilen pronë,në Komunen e Suharekës,mirpo te rasti i Zones industriale është një specifikacion që nuk kemi mujt me gjet qka me vepru me tutje,psh 18 kontrata të shkëputura në vitin 2016,mbas asaj shkëputje nuk pas as komision,as rekrutime as monitorime,deri sa kam ardhë unë Drejtor,ku kemi nis me dal në teren së bashku me zyrtarët e Pronës ne kemi pas shperputhje të mëdha midis kontratave të cilat jan perpili dhe që i kan zbatu në teren dhe kemi ardh deri në një komplikacion që nuk ka pas qka me ba Drejtoria e Pronës kurshkeptuen kontratat në 2016 dhe pas shkëputjes kontrates ai ka investu 2.000.000€ dhe e ka marrë lejen dhe është një biznes multifunksional dhe bën të hyra 100.000.000€ në vit dhe nuk kemi pas qka me i ba dhe kët çështje ne e kemi ngrit si arrativ si duhet shkohet më tutje,së bashku me Kryetarin kemi vendos paraprakisht ta themelojm një Komision në Asamble Komunale,mirpo ka dështu përshkak të përgjegjësive siq e tha Flamuri nuk kam interes për me shku në Prokurori sepse në monentin që e kam dorzu këtë raport ka shku ditën e par në Prokurori dhe unn hala jam duke u marrë me secilën parcelë,mirpo këtu u ngrit si çështje jashtëzakonisht shqetësuese dhe bashkarisht me gjet një zgjidhje dhe me dergu si pcedur më tutje.

Flamur Bytyçi-ti ke thënë që 10 biznese as nuk kan leje as nuk ka ndërtu kurgjo,qka kemi me prit më tutje pos me i shkëput kontratat.9 vite qeverisje pa komision,realisht qdo 6 muaj duhet me raportu për zona,dhe ju asnjëher skeni raportu.

Sanie Kuqi Rexhepaj-kur replikoj Armendi u lidh me kontrata 2016 Armend lidhu pak për kontrata që është bë në mandatin tënd si Drejtor dhe nuk jan monitoru dhe nuk jan ndertu komfort destinimit ose jan shfrytëzu nga dikush tjetër,këtë proces ka faj edhe inspektoriati edhe Drejtoria e Pronës edhe Kryetari Komunës,unë thashë që raporti ka mnangësi në disa specifikime përshkak se than ka leje ndertimore dhe ne nuk e dijm a e ka përfill atë leje ndertimore ,se ska as pranim teknik as qertifikat operimit mth problemet jan kogja të thella.

Mimoza Bajraktari-për pronat që tha flamuri kto duhet me ja marrë apo,atëher nëse i ka dhën Asamblea e këto duhet me ja marrëm Asamblea.

Dardan Berisha- na në KPF edhe në seancën e rregullt të Kuvendit komunal është kërku prej shumices së Asdambleisteve me bë komisione për secilen Drejtori me menagju me në një far forme

e dini ju mirë që nuk e kemi leju,për secilen Drejtori është Drejtori ne nuk jemi hetues me hetu Drejtorin jan pyetjet përgjigje jan raportet si raporti financiar dhe e kqyr si po menaxhohen punët,deshta e u lidh te kjo çështja që ka ardh në Kuvend dhe ne si Asambleist nuk e kemi pas guximin dhe nuk kemi pranë me marrë përgjegjësi sepse secili që kishim shku e kemi dit që qeky raport kish me ardhë i njejt ,dmth ne si Kuvend edhe nëse dojm me menaxhu Zonen ekonomike neve pona lejohet me shku në zon dhe me ba nje raport të tillë dhe me ia dorzu Kryetarit dhe nuk kemi pas vullnet asnjëri me marrë këtë përgjegjësi dhe është formu një komision prej Ekzekutivit që i përgzoj për punen,ja në zonën ekonomike ki hapësir me kritiku prej dites parë,është ligji për dhënjën shfrytëzim e ka një dy vjeqar nëse nuk investon 0 mundet me ja shfuqizu vendimin Kuvendi për me ja marrë atë parcelë,dmth ky problematik aq shumë është akomulu nuk ka zgjidhje të shpejtë,dhe ti me shku me ja shkëput kontratat dhe me kriju një situat tjetër sepse ti nuk ki të drejtë me ja marrë nëse investimin e ka bërë ,dmth ti një problematik e zgjidh e hap edhe disa të tjera,hapsir për kritika ka shumë,nuk ka kanalizim as edhe ndriçim dhe përdit ankohen bizneset,ne duhet me shku bazë te procedurave dhe në bazë të kriterëve dhe në bazë të hapsires si Kuvend që e kem,Ekzekutivi le ta lun rolin e vetë.

Enver Shabani- tu marrë për bazë problemet që jan rregullu në Zonen Industriale dhe i njohj mir që nga afer,unë kiisha propozu paka shume si Flamurime mbajtë një seancë të jashtëzakonshme për me diskutu me gjerë sepse ka probleme shumë të mëdha dhe nuk kryhet për një seancë dhe diqka tjetër që kisha propozu me formu një grup punues nga Kuvendi,nga Ekzekutivi,nga qendra e Bizneseve,nga bizneset aktive ,nga oj-q-të dhe me kqyr një fund qka me i rekomandu Kryetarit,qfar vendime me marrë,dhe me ja lehtu Kryetarit nuk e di a kemi te drejte dhe kisha propozu me formu një grup punues për problematikat që jan aty.

Flamur Bytyçi-po ta citojë raportin që e ka dorëzu Armendi së bashku me komisionin te Kryetari,ne rekomandim thotë në bazë të vlerësimit të komisionit dhe shqyrtimit të provave të ofruara si dhe nga gjendja ne teren ,komisioni në raport ju paraqet gjendjen aktuale për zonen industriale në Shirokë dhe Agrozonen në Samadrexhë,rreth zbatimit të kontratave për secilen parcelë të cilët i kan në shfrytëzim andaj rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të rishqyrtojë këtë raport dhe të vendos në pajtueshmeri me ligjin për dhenien në shfrytëzim në këmbim të pronës së paluajtshme ligji nr 06L 092 dhe rregulloren për percaktimin e procedurave dhenjes në shfrytëzim dhe në baze të këtij raportit duhet me u shkëput kontratat.

Kryesuesi- e hedhë në votim

6 për,4 kundër,1 abstenim miratohet

Pika 10. Raporti për vlerësimin e dëmeve të vërshimeve.

Kryesuesi- e kem edhe këtë pikën shtesë që e diskutum në fillim,dhe e hedhë në votim

4 vota për,2 kundër,1 abstenim miratohet

Kryesuesi-ja jep fjalën Nënkryetares për një fjalë përshendetëse.

Takimi përfundoi:12:02

